



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T I

Nga procesverbali i mbledhjes së 34-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 24.10.2024, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Shefki Bytyqi, anëtar
3. Gazmend Qerkini, anëtar
4. Shkelzim Olluri, anëtar
5. Albiona Tasholli, anëtare
6. Fadil Sopa, anëtar
7. Sami Bytyqi, anëtar
8. Fitim Shala, anëtar
9. Xhyzide Rrustemi, anëtare
10. Rinor Murati, anëtar
11. Armend Grajqevci, anëtar
12. Gentianë Hoxhaj, anëtare
13. Venhar Agushi, anëtar
14. Xhyla Dedushaj, anëtare
15. Lulzim Rrustemi, anëtar
16. Herolind Kozhani, anëtar
17. Ardit Cani, anëtar
18. Arsim Jashari, anëtar
19. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
20. Ganimete Qeriqi, anëtare
21. Alban Salihu, anëtar
22. Fitim Meziu, anëtar
23. Fadil Spahiu, anëtar
24. Fatmir Fetahu, anëtar
25. Shahadije Dragaçina, anëtare
26. Besiana Sylja, anëtare
27. Enver Kryeziu, anëtar
28. Bashkim Budakova, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Diamant Bytyqi, Nënkyetar i komunës
2. Lulzim Qerimi, Nënkyetar i komunës
3. Latif Ramadani, DBF
4. Shkelzen Hajdini, DSHMS
5. Elmaze Behluli, DA
6. Sead Aliu, DI
7. Valon Pacolli, DEZH
8. Rexhep Rexhepi, DBP
9. Rasim Hasani, DKA
10. Safete Amerllahu, DGJK
11. Burim Rrustemi, DSHPMSH
12. Imri Semetishti, DUPMM
13. Anila Reqica-Llugiqi, DKRS
14. Përfaqësues të mediave dhe shoqërisë civile dhe të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit, tha se uroj që jeni mire, pastaj tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë me kohë, pastaj lexoi rendin e ditës të propozuar:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 33 -të e Kuvendit-së.
 2. Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Shtator 2024.
 2. Propozim Vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës ZK-Lipjan.
 3. Propozim Vendim për caktimin e shkallëve tatimore progresive në pronën e paluajtshme për vitin 2025.
 4. Propozim Rregullore për organizimin e punës së institucioneve edukative - arsimore të Komunës së Lipjanit.
 5. Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për Islamik Relief Worldwide – Zyra në Kosovë (IRW).
- Kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, tha se e kemi edhe një pikë shtesë, për të cilën do të ju njoftoj drejtori i buxhetit.
- Latif Ramadani, tha se si pikë shtesë e propozojmë, Propozim Vendim për transferin e ndarjeve buxhetore për harmonizimin e pagave për vitin 2024.

Ky propozim vendim vie për arsye të minusit të pagave në disa nën programe si shkak të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore nga përmbaruesit privat për mbulimin e kontratës kolektive në arsim.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se është ka bëhet një praktikë e keqe të paktën kemi mundur dje në KPF me pru si pikë që me pas ne hapësirë me e analizuar. Ne grupi i PDK-së, jemi kundër këtij propozimi.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se rregullorja e punës se kuvendit e lejon qe pikat me u propozuar edhe ne kuvend. E dyta drejtori dje e përmendi në KPF, që do ta kemi një pike shtesë e cila ka ardhë në kuvend.

Pastaj Kryesuesi i kuvendit hodhi ne votim propozimin me pikën shtesë dhe pas votimit u konstatua se me 12 vota për,10 kundër u aprovua rendi i ditës.

Pastaj u kalua në pyetjet e anëtarëve të kuvendit?

Besiana Sylja, tha se do ti ngris disa probleme me të cilat atakohen çdo ditë banorët e fshatrave: Glllogovc, Topliqan dhe Sllovi. Në Glllogovc në rrugën “Imer Prizreni”, gjendja e trotuarit është e mbuluar me barishte dhe mjaft e dëmtuar. Nevojitet që të pastrohet. Banorët e fshatit Topliqan, përballen me mungesë te ujësjellësit në disa lagje, po ashtu ka mbeturina te shumta në fshat dhe numër të madh i qenve endacak. Në fshatin Sllovi, Kryetari i pat premtuar 3 minibusë për fshat për bartje të nxënësve, mirëpo ky premtimin nuk është realizuar, pasi që aty ka një autobus të vetëm i cili nuk i plotëson aspak kushtet.

Shahadije Dragaçina, tha se kërkoj një sqarim nga drejtori i shëndetësisë, çka po ndodh me ambulancën në Janjevë e cila pak ditë pas ndërtimit i është dëmtuar tavanin. Çka ka ndodhur me tavanin e ambulancës. Pyetja tjetër autobusi, Prishtinë-Janjevë ka filluar të qarkulloj mirëpo, është një shqetësim i banorëve, të cilët kërkojnë të vendoset një shenjë që ndalon parkimin e veturave në qendër, pasi qe autobusi po ka problem të kthehet në atë vend. Kërkoj një sqarim nga drejtori për bujqësi për njoftimin qe është bërë për shpërndarje të serave, si është e mundur që kjo organizatë me ndarë pajisje bujqësore kur ne ende sot kemi me ja ndarë mjetet ne kuvend kësaj organizate.

Ganimete Qeriqi, tha se një dukuri që ma ka nxënë syri çdo ditë, është Rruga Magure- Aeroport, te trekëndëshi ku presin qytetaret për Drenicë që shfrytëzohet për

stacion, është një hapësirë pa sinjalizim dhe nuk ka siguri aspak për qytetarët që presin aty. Është mirë ajo pjesë me u rregulluar edhe ndriçimi publik si dhe vendi për pritje. E dyta është mirë që janë shtuar aktivitetet për Shtjefën Gjeçovin. Mirëpo, Gjeçovi i ka lënë dy mbesa dhe ato janë në gjendje të keqe, ku njëra është në gjendje në rëndë shëndetësore, në regjim shtrati. Dhe ato kanë nevojë për banim, qoftë ndërtimin e një shtëpi apo blerjen e një banese .

Arsim Jashari, tha se së pari, ambienti në sallë nuk është i përshtatshëm për mbajtje të mbledhjes, sepse është shumë ftoftë. Kam disa pyetje dhe kërkesa, e para për DKA-në, para disa dite kam bërë një reagim në rrjete sociale, për orarin e çerdheve publike në Lipjan, e cila çerdhe fillon orarin e punës në ora 7: 00 dhe përfundon në 16:20, ndërsa çerdhet në komunat tjera fillojnë në ora 7:30 dhe e përfundojnë punën në ora 19:10. E dyta, në këtë çerdhe nuk ka edukatore kujdestare, është mirë me u përzgjedh një kujdestare dhe me u ndryshuar orari. E dyta për drejtorinë e kulturës, çka po ndodh me palestrën sportive në Lipjan pasi që kanë kaluar 11 muaj nga përrurimi dhe ajo palestër ende jashtë funksionit, ende është e mbyllur. Ku është problemi. Tjetra në atë palestër është pranuar një punëtor, në përshkrim të vendit të punës është “rregullimi i orarit të klubeve të sportit” aty nuk janë duke u zhvilluar ndeshje, ai zyrtar merr rrogë me këtë po keqpërdoret buxheti dhe taksat e qytetarëve. Te drejtoria infrastrukturës, të ndërtimi i rrugëve po behet kualiteti i punëve shumë i dobët, pse po ndodh kjo, shikoni trotuarin në rrugën Gllgovc-Bujari në çfarë gjendje është (ku i keni dhe fotot që ua kam sjell dhe po ua lë juve). E kam një kërkesë të një banori të fshatit Topliqan ,Bajram Daka të cilit ju ka bllokuar që disa ditë kanalizimi dhe nuk ka shkuar askush për ta rregulluar është mirë të merren masa. Për DKRS-në, çka po ndodh me klubin e futbollit Ulpiana, a e keni parë gjendjen e stadiumit është e mjerueshme, aty është investuar miliona euro dhe mirëmbajtja është zero.

Lulzim Rrustemi, tha se kam një kërkesë për drejtorin e bujqësisë që në mbledhjen e ardhshme të na sjellni një raport detal, për dhënien në shfrytëzim të tokave bujqësore. Pyetje për drejtorinë e infrastrukturës çka po ndodh me ujësjellësin e fshatrave Kraishtë, Bujan, Ribar i Madh dhe fshatrat e tjera. Shtegu i ecjes në Gadime çka po ndodh me atë projekt pasi që ka mbet në gjysmë. Projekti tjetër që ka mbet në gjysmë është projekti i parkut dhe hapësirave të parqeve dhe mbjellja e drunjëve në Poturovc çka po ndodh me këtë projekt?

Alban Salihu, tha se çështjet që kam për ti ngritur, disa prej tyre i ngritën edhe parafolësit, shqetësim edhe për mua është palestra sportive e qytetit, e cila u promovua para një viti, për të cilën unë pata reaguar në rrjete sociale për kundërshtimin e këtij projekti, u pat kundërshtuar nga ana juaj, mirëpo siç po shihet

gjendja është e njëjtë, edhe pas një viti. Kemi informata që edhe kulmi i sallës është duke u renovuar. Pse gjithë ajo nguti me e promovuar kur nuk ka qenë gati. Shumica e klubeve ne Lipjan po përballen me kushte të tmerrshme infrastrukturore. E dyta, kam një pyetje për shtyllën elektrike te rrethi për Magurë, çka do te bëhet me të. Pasi që edhe media ndërkombëtarë kanë shkruar për këtë shtyllë. Tjetra, ditëve te fundit i kam bërë disa reagime për mirëmbajtje të trotuareve, dhe parqeve ku mbi 90% e trotuarit në disa raste është e bllokuar nga mbeturinat. Në oborrin e objektit të çerdhes në Lipjan shihet një grumbull i mbeturinave, ku mund ti shihni edhe fotot që i kam bërë të cilat i kam marr me veti. Kjo gjendje kishte qenë e njëjtë dhe ne vitin 2016, e për te cilën dhe atë vit unë kam pas të njëjtin reagim në rrjete sociale ,dhe qe 8 vite kjo qeverisje nuk ka mundur me i larguar ato mbeturina.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha me lejoni qe fillimisht te lexoj një njoftim, të cilin ia ka dërguar DKA-ja, drejtorëve të shkollave, pastaj ata e kanë shpërndarë te mësimdhënësit të cilën e lexoni në vijim lidhur me kompensimet të cilat janë si rezultat i një procesi gjyqësor, përveç paditësit është e njoftuar edhe e paditura Komuna e Lipjanit. Është dasht me këtë shkresë me ju drejtuar gjykatës e jo personelit arsimor, sepse ata nuk janë jurist, as avokat e gjyqtar dhe nuk e dine këtë çështje. Cili ka qenë qëllimi i këtij njoftimi, kjo ka shkaktuar konfuzion dhe frikë te këta mësimdhënës dhe me këtë ata po ndihen të frikësuar. Pasi me këtë njoftim janë ndier të kërcënuar dhe shantazhuar.

Egzona Bytyqi, tha se unë do të fokusohem te shëndetësia. E para në cilën fazë të implementimit është përzgjedhja e mjekut familjar dhe cilat janë sfidat të cilat i ka komuna jonë lidhur me programin me projektin e përzgjedhjes së mjekut familjar. E dyta, jemi në muajin e solidaritetit në muajin e vedijesimit kundër kancerit të gjirit, dua të di se sa ka qenë numri i grave dhe vajzave që kanë kërkuar të bëjnë ekografi apo mamografi. Tjetra si ka mbet statuti i QKMF-së, a ka ardh ligjshmëria e këtij statuti. Pyetja tjetër i propozoj drejtorisë së shëndetësisë që në bashkëpunim me psikologen, këshillin e prindërve dhe akteret e tjerë relevant të fillojnë me fushata ndergjegjësuere që me shfrytëzuar në mënyre sa më racionale teknologjinë. Është mirë të marrim masa parandaluese. Çështja tjetër ka filluar shpronësimi i parcelave ne ZK Qylagë, për depononi ilegale, dhe në duhet përmes peticioneve apo ne çdo mënyre tjetër për ta kundërshtuar këtë deponi.

Ardit Cani, tha se kam disa çështje të cilat i kam ngritur edhe me herët, e para ka te beje me ndërtimin e trotuarit në rrugën kryesore në Resinovc por edhe brenda fshatit. E dyta a është nënshkruar kontrata për mirëmbajtjen e ndriçimit publik pasi që po ka probleme me ndriçim në disa fshatra për shkak te prishjes se poqave. Dhe

vendosen apo kontrollohet nga dikush cilësia e atyre dritave. Tjetra të bëhet vendosja e shenjave që ndalojnë hedhjen e mbeturinave në lokacione të ndryshme në zona po bëhen deponoi ilegale. Kërkesë për drejtorinë e bujqësisë a ka filluar zhavorimi i rrugëve bujqësorë dhe deri ku ka shkuar si projekt. Kërkesa tjetër vendosja e policeve te shtrire afër shkollës ne fshatin Baincë.

Herolind Kozhani, tha se çështja e parë të cilën do ta ngris ka të bëjë me rrugën “Rrahim Hoti” në Ribar të Madh që lidhet me fshatin Torinë e cila eshët bërë e pa kalueshme, për shkak te një gypi te kanalizimit që ka shkaktuar probleme. E dyta, ka të bëjë me menaxhimin e projekteve në teren, ku shumë projekte nuk po përcjellën si duhet dhe po ikin shume çështje pa u kryer, ndërsa projektet po kryhen sa për sy e faqe .

Rinor Murati, tha se ju përgëzoj për agjendën një mujore për ndërgjegjësimin kundër kancerit të gjirit. Kam një kërkesë për drejtorinë e administratës, pasi që një pjese e shërbimeve po kryhen në platformën E-Kosova, konsideroj që është e nevojshme vendosja e një kompjuteri dhe printeri për dokumente të cilat shkarkohen nga kjo platformë. Ne fund po e ngris çështjen e mos realizimit dhe mos pagesave për punën e komiteteve dhe komisioneve. Unë e kam ngrit këtë çështje në ministri por edhe te avokati i popullit, të cilën në fillim e ka aprovuar si te bazuar në parim, pastaj në vendimin e fundit i ka ritheksuar ato që i thotë ligji. Pres që ju kryesues se bashku me shefat e grupeve të bisedoni rreth kësaj çështje dhe të gjeni një zgjidhje.

Diamant Bytyqi nënkryetar i komunës tha se është e rëndësishme që transporti ne fshatin Sllovi po bëhet, pak është e rëndësishme a bëhet me një komibus apo me 3 kombibus, kryesorja, komuna po e mbulon transportin. Në Topliqan ne tër fshatin mungon ujësjellësi jo vetëm në një lagje. QMF ne Janjevë, është dëmtuar pasi ne katin e dyte banon një familje dhe është shkaktuar një telash ku ka pas problem me kulm. Kombibusi në Janjevë është lëshuar do te vendosen dhe shenjat tjera njoftuese për autobusë në ditët ne vijim. Si aktivitet janë rikthyer ditët e Gjeçovit ne Janjevë. Dy vajzave mundemi me i ndihmuar përmes kërkesës, përmes subvencioneve aq sa ka mundësi kryetari, por është dhe një program në ministrinë e kthimit. Palestra sportive i ka pas disa telashe dhe shume shpejt do te jetë ne dispozicion. Ndërsa punëtori është i drejtoratit jo vetëm për palestër. Orari i çerdheve e di qe ka vështirësi për prindër, mirëpo për shkak të stafit të vogël të punëtorëve e kemi të pamundur një mundësi të tillë. Te kualiteti i punimeve kemi menaxheret e kontratave të cilët janë përgjegjës për punën si po kryhen. KF Ulpiana, është edhe për neve një shqetësim, kryetari e ka marr një vendim për themelimin e një komisioni atëhok për vlerësimin e situatës se stadiumit Ulpiana. Ulpiana është në prag të organizimit të klubit, dhe për momentin

janë duke menaxhuar me stadiumin. Raporti për pronat bujqësore, është publik por mund ta sjellim edhe një raport për pronat bujqësore për bujqit që i shfrytëzojnë. Ujësjet në Kraishtë është projekt me CDI-në por ata kanë probleme të veta. Shtigjet në Gadime ka përfunduar si projekt. Parqet ne Poturovc kontrata është ndërprere dhe nuk është realizuar projekti por pritet kontrate e re me u lidh. Për palestër e thash që ka pas një defekt shumë shpejt do të jetë e gatshme. Shtylla elektrike do të largohet brenda pak dite nga ai vend. Sa i përket mbeturinave të çerdhja, ne kemi paraqitë një kërkesë për themelimin e kompanisë Ulpiana mirëpo që 3 vite nuk kemi ndonjë njoftim nga ana e ministrisë. Projekti i mjekut familjar është duke vazhduar edhe këshilli i pacienteve po i njofton qytetaret rreth kësaj çështje. Numri i atyre që janë duke e kryer mamografine tani e kemi në Lipjan por deri tash nuk është edhe aq i madh numri. Te shqetësimet e nxënësve e kemi diskutuar dhe në KKSB, edhe pse është një sfidë e madhe edhe për nxënës edhe për mësime dhënë dhe prindër. Për vendosjen e deponisë në Qylagë jemi kundër dhe do të kundërshtojmë në çdo mënyrë përmes peticioneve protestave apo në çdo mënyrë tjetër. Për ndriçim publik ende nuk është lidh kontrata. Rrugët bujqësore kanë filluar në disa fshatra. Komitetet dhe komisionet nuk po kemi mundësi për ti paguar pasi që nuk po kemi mundësi ligjore. Vendosja e një kompjuteri me një printer në koridor të komunës për qytetar mund ta bëjmë.

Rasim Hasani, tha se njoftimi, është vetëm një njoftim, dhe nuk ka të bëjë as me kërcënim as me asgjë tjetër. Nuk besoj që asnjë mësime dhënë është ndjerë i kërcënuar. Shkresa është bërë në bashkëpunim me avokatin publik të komunës, pasi që punëtoret arsimor për të njëjtën padi kanë marr dy herë pagesë, dhe kjo ka ndodh sepse ata kanë më shumë se një padi me avokat të ndryshëm. Avokati e ka përfshi edhe pjesën që nuk u kanë të kontraktuar. Punëtoret arsimor nuk janë aq të paditur sa që nuk e dinë si i kanë marr ato mjete. Nuk i ka premtuar kryetari 3 autobus për Sllovi asnjëherë. Ne i kemi 17 kontrata ku i bartim nxënësit në shumicën e shkollave. Transporti i nxënësve në Shqipëri është me parat e tyre dhe ligji ja mundëson me zgjedh shkolla vet operatorin. Përgjegjësia e komunës është vetëm një zyrtar me dërgua për anëtar në komision. Shkolla vet ka vendos se cili operator me i dërguar.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se momentin që më ka ra mua në dorë ky njoftim ka pakënaqësi. E dyta unë nuk thash që ka punëtor të pa shkolluar të arsimit. E treta komuna nuk duhet me marr përvoja nga komunat tjera, pasi që komunat tjera jua kanë ndaj mjetet pa i qua në gjykatë, pasi që me pas marr mostër komunat tjera ish dashtë me nda mjetet pa i qua në gjykata hiç. Ju ftoj prapë që ti verifikoj avokati, sepse nuk janë shumë lëndë 1 mijë.

Besiana Syla, tha se ato çështje që i ngrita janë kërkesa të qytetarëve, arsyeja pse nuk e kam votuar buxhetin është sepse nuk i ka përfill kërkesat e qytetarëve. Dhe derisa nuk i prek interesat e qytetarit nuk e votoj buxhetin.

Alban Salihu, tha se cili ke zori që e promovuat pa u përfunduar këtë palestër, pasi që e keni ditë që nuk është në rregull dhe nuk i ka plotësuar kushtet. Te mbeturinat nuk është punë shume e madhe me një telefonate kishin mujt ato mbeturina me u larguar.

Arsim Jashari, tha se qytetarët nuk mundën me shkuar te titullarët e kontratave me ju thënë hajde pastrojeni trotuarin. Trotuaret dhe rrugët duhet te pastrohen dhe mirëmbahet. Te punëtori i palestrës, unë e kam pa shpalljen dhe aty i ka detyrat e punës. Sa i përket ekskursioni në Shqipëri nuk mund të besoj që është bash aq si po e thoni ju, kur dihet se shumicën e drejtorëve të shkollave i kemi kryetar të nëndegëve.

Diamant Bytyqi, tha se kërkesat e qytetarëve ne i kemi paraparë në buxhet, Çështja e palestrës shumë shpejt do të jetë e gatshme për klube lipjanase. Ta kishim ndërmarrjen Ulpiana ne do ta kishim më lehte për të i kryer edhe me shume kërkesat e qytetarëve.

Rasim Hasani, tha se asnjë drejtor i shkollës nuk është kryetar i nëndegës, e dyta që 10 vite nuk ka pas asnjë çmim më të lirë se sivjet për ekskursion se që e kanë nxënësit e komunës së Lipjanit.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se e kam një propozim që nga mbledhja e ardhshme të i lëmë në fund pyetjet dhe përgjigjet pasi që po zgjatë shumë mbledhja.

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 33-të e Kuvendit

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë.

Pastaj Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, vuri në votim ekstraktin nga mbledhja e 33-të e Kuvendit, pas votimit konstatoi se Kuvendi me, 23 vota për aprovoi

Ekstraktin nga mbledhja e 33 të, e Kuvendit.

Shtesë: Ekstrakti

II

Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Shtator 2024.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadani, DBF, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti

Daut Azemi, kryesues i mbledhjes tha se kërkoj një pauzë prej 5 minutave , po ashtu nuk kemi edhe kuorum.

Pastaj pas pauzës Kryesuesi e hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi, tha se raporti është obligim ligjor që po e kryejmë si kuvend. Buxheti dhe shpenzimet sipas fondeve burimore janar shtator 2024 janë shpenzuar mbi 70% e buxhetit dhe është një shpenzim solid, mirëpo ka edhe sfida të cilat po i theksoj. Nga granti qeveritar kanë mbet ende mjete pa u shfrytëzuar. Te buxheti sipas kategorive ekonomike po ashtu edhe këtu kane mbet një shume e pa shfrytëzuar e mjeteve . Te të hyrat vetanake, dhe te të hyrat vetanake të bartura edhe këtu një përqindje e madhe pa u shfrytëzuar. Te kujdesi primar shëndetësor shpenzimi është zero dhe kjo është sfiduese. Te arsimi fillor janë shpenzuar vetëm 27% e buxhetit edhe kjo është shqetësuese . Te investimet kapitale te shumë projekte shpenzimi është zero. Asfaltimi i rrugicave në disa fshatra edhe këtu ende kemi shpenzim zero. Fushat në Magurë dhe Dobrajë rrezikojnë prapë të përfundohen, sepse i ka marr thesari mjetet. Në këtë buxhet ka shume projekte pa shpenzim fare ose me shpenzim zero.

Daut Azemi, tha ju kisha lut që nga mbledhjet e ardhshme kur të diskutoni për pika të mos i laboroni, pasi që po i laboron drejtori por bëni pyetje nëse keni apo pa qartësi.

Besiana Sylja, tha se siç po shihet nga raporti është një shpenzim i kënaqshëm i buxhetit të aprovuar mbi 73%. Kategoria ekonomike paga dhe mëditje, jeni në minus mbi 300 mijë euro, me këtë mund të mbesin pa paga në muajin dhjetor. Te shërbimet postare kemi shumë të madhe, te të hyrat nga qiraja ka te hyra jo te kënaqshme. Te investimet kapitale ende kemi projekte që nuk kane filluar me shpenzim dhe mjetet mund të shkojnë suficit. Po ashtu kemi raste kur komuna ka shpenzuar pa hyrë ne zotim të mjeteve. Pse komuna ka hyr në obligim pa zotim te mjeteve.

Latif Ramadani, tha se unë paraqita një shpenzim real i cili ka ndodh për secilën kategori veç e veç i detajuar. Janë disa projekte që nuk janë shpenzuar mjetet sepse ende nuk kanë filluar puna. Ne dhjetor do ta kemi edhe më problem pasi që do

të na merr thesari mjetet. Ne raport keni një shpenzim real për atë që ka ndodh brenda këtyre muajve.

Besiana Syla, tha se ne duhet me dite ku qëndron problemi ,buxhetin e keni të miratuar, i keni në dispozicion mbi 2 milion euro. Mirëpo ju me këtë buxhet je minus 300 mije euro. Dhe me këtë ju jeni fajtor jo ministria.

Latif Ramadani, tha se është përgjegjësi e ministrisë, dhe nuk është problem vetëm Lipjani, por te gjitha komunat e Kosovës, pse me herët nuk kemi thënë qeveria i ka fajet. Me përmbarues na kane marr pagat dhe kjo qeveri nuk meriton me udhëheq.

Meqë diskutime të tjera nuk pati u kalua në pikën në vazhdim.

III

Propozim Vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës ZK-Lipjan.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Imri Semetishtit, DPUMM i cili, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi, tha se ne si komision kemi bërë një punë të madhe, por si anëtar i komisionit kam pas rezervat e mija dhe kam pas mospajtime rreth konsersiumit dhe vërtetimit të ATK-së. Unë konsideroj qe konsersiumi mundet që vetëm me një projekt. Ndërsa te ATK-ja, vërtetimi i ATK-së, mendimi im është se duhet me vle dhe kur ka marrëveshje. Në këto dy pika unë nuk jam pajtuar. Ne kemi vazhduar me punën. Ne si grup i PDK-së, do të votojmë kundër.

Imri Semetishti, tha se ne kur e kemi hartuar njoftimin publik, kemi përcaktuar 3 grupe te kriterëve: duke i përfshirë kriteret administrative, kriteret financiare dhe teknike. Ne kuadër te kriterëve administrativë janë paraqitur 7 te tilla, njëra ndër to pagesa e detyrime në ATK, E dyta qe te këtë te paktën të ndërtuar një ndërtesë afariste prej 10 mijë metra katrorë, apo 40 njësi banesore. Po ashtu edhe pagesën tatimore, vërtetimi nga ATK qe i ka kryer te gjitha detyrimet. Ne si komision kemi vepruar ne baze te legjislacionit ne fuqi.

Alban Salihu, tha se u diskutua nga qytetaret pse po fillojnë shpronësimet me kaq me nguti pa i pritur vendimet e gjykatave, pa u respektuar vullneti i banorëve. Dhe tash po shihet pse na ka ardh ky dokument kaq me nguti, pasi qe fitues i kësaj oferte është shoku i ngushtë i kryetarit te komunës dhe avokati i tij personal.

Imri Semetishti, tha se objekti ku janë bërë shpronësimet janë te çekini, dhe nuk përfshihet me këtë vendim qe po flasim, por ne një vend tjetër, unë ketë sqarim deshta ta beje.

Alban Salihu, tha se është e qarte se për cilin objekt po flasim ne. Por pyetja ime për juve është a jeni ne dijeni qe ofertën e ka fituar shoku i kryetarit dhe avokati i tij?

Imri Semetishti,tha se sa për njohurinë e te gjithëve hapësira ku ndahet objekti i çekinit deri te parcelat ku përfshihen parku i qytetit me sheshin ka hapësirë 34 metra gjatësi. Komisioni e ka krye punën e vete, njoftimi ka qen publik dhe ka fituar oferta që ka qen më e favorshme.

Armend Grajqevci, tha se edhe unë kam qen pjese e komisionit dhe është bere një pune intensivë dhe profesionale e komisionit. Dy çështjet qe i ngriti parafolësi për konsersiumin edhe dokumentin e ATK-së, kemi diskutuar dhe kemi marr vendim adekuat. Ndërsa pyetja për asambleistin tjetër është për të se ku është asambleistja juaj tani kur po diskutohet për këtë pikë, Nëse mendon qe ka pas keqpërdorime nga dikush ju mundeni me i përdor të gjitha instancat dhe nuk duhet të mirrën me shpifje fitoi ai ose ai.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se secili nga mundemi me pas një shok a një avokat. Dhe nuk d.m.th. qe kjo është konflikt interesi.

Alban Salihu, tha se shqetësimin qe e tha parafolësi, ku është asambleistja jonë, nuk është mirë me ju interesuar. Mirëpo nëse ju intereson është mirë me i lexuar ligjet dhe rregulloret dhe ato e përcaktojnë qartë kur ka konflikt interesi, nuk duhet me marr pjese dhe ne e kemi njoftuar qe duhet me lirua sallën. Dhe e ka liruar sallën dhe është treguar e përgjegjshme.

Armend Grajqevci, tha se ne bazë të ligjit nuk ka drejt me votuar mirëpo ka drejt me marr pjesë në sallë.

Lulzim Rrustemi, tha se unë i kam dhënë mendimet e mija ne komision rreth konsersiumit dhe vërtetimit të ATK-së dhe qëndroj prapë me te njëjtin qëndrim.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se drejtori e dha shume mire sqarimin, në baze të ligjit janë bere kërkesat. Dhe në bazë të konkursit janë caktuar edhe kriteret me te cilat kane punuar edhe komisioni.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 15 vota për, 9 kundër, 2 abstenim aprovoi propozimin

Pastaj kryesuesi i kuvendit Daut Azemi, dha pauzë nga ora 12:00 deri në 14:00

IV

Propozim Vendim për caktimin e shkallëve tatimore progresive në pronën e paluajtshme për vitin 2025.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadanit, drejtori për DBF, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se duke e pare nivelin e pagave, inflacionin dhe gjendjen e qytetarëve, me na ardhje kjo norme progresive është e pa pranueshme për qytetaret. Është një goditje e rende e cila ka me qene e pa përbalueshme. Unë i kam nxjerr disa te dhëna ku nëse ke prone mbi 1 milion euro i bie me i paguar 2400 euro ne vit. Norma progresive e tatimit ne pronë nuk ka kuptim ekonomik, sa ma e lart te jetë vlera e pronës aq më e larte ,do te jetë ngarkesa tatimore. Nga viti 2025 do te tatimohen edhe pronat bujqësore edhe pyjore. Ne si grup i PDK-së, nuk do ta votojmë këtë propozim pasi qe me këtë propozim dëmtohen qytetarët.

Rinor Murati, tha se para nesh e kemi një propozim vendim te cilin duhet ta mbështesim apo thënë ndryshe detyrohemi ta mbështesim, për shkak te kornizës. Edhe pse kjo është një barrë e jashtëzakonshme për qytetarët.

Alban Salihu, tha se unë nuk pajtohem me parafolësit, pasi qe norma progresive i ngarkon me shumë ata qe i kane pronat me të shtrenjta. Kush do qe ka ma shume do te paguaj më shumë. Ideja e kësaj politike ka qene kush ka me shume të paguaj më shumë.

Latif Ramadani, tha se vlerësimin e pronave e bën departamenti i pronës. Ne si komune se bashku më asociacionin e komunave e kemi kundërshtuar këtë rritje dhe këtë norme progresive, pasi që do ti dëmton qytetarët. Ne e kemi kundërshtuar si komunë sepse e kemi dite që është ngarkese e madhe për qytetarët, ne kemi caktuar minimumin si komunë.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se prej vlerës mbi 100 mijë euro deri 500 mijë euro është plus tatimi 0.30, është mirë që këtë me ju sqaruar qytetarëve.

Alban Salihu, tha ne e abstenojmë këtu vendim. Por kur po thuhet këtu se te gjitha komunat, apo këta përfaqësuesit e komunave që nuk lejuan me hy ne votim futjen në asociacion të komunave veriore. E dyta nuk ka nevojë me ju qa halli atyre që kane biznese të mëdha, sepse ata kanë investuar më shume dhe duhet me qenë më te përgjegjshëm ndaj komunitetit.

Arsim Jashari, tha se unë nuk jam kundër vendimit te komunës ,pasi që ne kemi votuar çdo vit këtë propozim . Por roblemi është te norma progresive.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se ajo që e tha Albani nuk është e vërtet, sepse unë se bashku me dy anëtare të kuvendit kemi qenë delegat dhe nuk është e vërtete ajo që është thënë nga ana juaj, sepse ato komuna janë pjesë e kuvendit, mirëpo ka qen një plan i përgatitur nga delegatet e LVV-së me video.

Rinor Murati, tha se çka do te ndodhë me ata qytetarë, që kanë prona bujqësorë dhe te cilët po detyrohen me këtë barrë.

Armend Grajçevci, tha se e përmendi dhe parafolësi, bujqit që i punojnë tokat e për te cilët do te jetë një barrë e madhe çka do të ndodh me ta, Vlera e tokës nga Ribari deri në Kleçke është mbi 800 euro ari.

Latif Ramadani, tha se prej deri 100 mijë euro taten 10% ndërsa mbi 500 mijë është 30% plus 20, plus 10 %. Mbi 1 milion është edhe shume norma progresive që e goditë çdo qytetar të Kosovës. Tani janë edhe pronat bujqësore dhe tokat pyjore dhe grumbullohen te gjithë, dhe në fund shuma e përgjithshme.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 14 vota për, 4 kundër, 5 abstenim aprovoi propozimin

V

**Propozim Rregullore për organizimin e punës së institucioneve edukative -
arsimore të Komunës së Lipjanit.**

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Rasim Hasanit, DKA-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se fillimisht një rregullore voluminozë, ajo që me ka shqetësuar edhe që e ngrita edhe në KPF është që mësimmshënësit i kane vendosur në ligjin për zyrtar publik. Sidomos te masat që është e pa pranueshme. Unë i kam nxjerr disa vërejtje si: te neni 7, pika 1.20 njoftimi për trajnime, duhet të bëhet 3 ditë me herët, këtu është mirë që trajnimet me u mbajt gjatë ditëve të pushimeve. Te shkollat nën 250 nxënës duhet drejtori ti mbaj 10 ore mësimi. Te detyrat e kujdestarisë, mos është udhëzimi gabim teknik, mos duhet të jetë 8/22 . Edhe te kujdestari për me ardhë 15 minuta më herët mjafton, e jo 20 minuta. Po ashtu te hyrja e shkollës është mirë me pas aparatit për hyrje dalje ,e jo kujdestari mu marr me këtë çështje. Dhe te gjobat si do të zbatohen gjobat si do ti merren mjetet. Nëse i merrni propozimet tona do të votojmë pro kësaj rregullore .

Shahadije Dragaçina, tha se ajo që dua ta eidentoj është fakti se debati i hapur publik që është mbajt me qytetaret për këtë rregullore është mbajt me datën 14, po në të njëjtën ditë na ka ardhë neve materiali duke përfshirë edhe rregulloren. Në njoftimin e komunës për çdo sugjerim kërkesë, ka qene deri me datën 18 si ka ndodh kjo, pasi që për mua është pa përgjegjësi dhe shqetësuese.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se unë kam pas më dërguar materialin një ditë më herët, sepse ndryshimet mundemi me i marr edhe sot, pasi që më herët ka pas konsultim publik për këtë rregullore dhe ky ka qenë i fundit.

Bashkim Budakova, tha se kam një pyetje rreth rregullores. A keni një statistikë të shëndetit mendor në institucionet edukativo arsimore në nivel komune. Kur dihet që tash shkollat kanë edhe bashkëpunëtor profesional, pedagog, psikolog logoped, mjek e te tjerë. A kemi një përqindje te kësaj natyre që mund të i ndalin dukuritë negative.

Rasim Hasani, tha se të fundit nuk e kuptova bash drejtë, nuk kemi ndonjë statistikë, i kanë raportet drejtoret por unë nuk i kam. Rregullorja i ka kaluar te gjitha fazat e konsultimeve publike dhe nuk kemi marr asnjë vërejtje të vetme dhe ditën e

fundit nuk është që e kemi prit ndonjë ndryshim. Futja e mësimdhënësve në ligjin për zyrtar publik janë trajtuar si administratë mirëpo kjo nuk hec në këtë formë. Te gjobat ose te masat, në nuk mundemi me e ulë në pozitë mësimdhënësin dhe nuk mundemi me bo punëtor teknik. Mundemi me sanksionuar por jo me ulë në pozite. E dyta me transferua nuk mundemi sepse afekton të mësimdhënësi tjetër. Te gjoba me një vendim të punëdhënësit, ndërsa të nxënësit detyrohen prindërit me sanuar një defekt ose me pagur si gjobe. Te trajnimet bënë dhe ministria dhe organizata të ndryshme dhe nuk mundemi me ua diktuar agjendën dhe ditën. Nëse ka gabim duhet me përmirësuar vitin të udhëzimit administrativ.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit me propozimin që nëse ka gabim teknik të viti të udhëzimit administrativ të përmirësohet, pa pas nevojë të vie prapë në kuvend. Pas votimit konstatoi se Kuvendi me 15 vota për, 3 abstenim, aprovoi propozimin

VI

Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për Islamik Relief Worldwide – Zyra në Kosovë (IRW).

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Rexhep Rexhepi, drejtor i DBPZHR-së i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se në grupi i PDK-së, e mbështesim këtë propozim vendim dhe votojmë pro.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 19 vota për, aprovoi propozimin

VII

Propozim Vendim për transferin e ndarjeve buxhetore për harmonizimin e pagave për vitin 2024

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadanit, drejtori për DBF, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi. Pastaj drejtori tha se ka një ndryshim të propozimi, kur i kemi llogaritë shtesat e kuvendit për muajin gusht dhe shtator. Pra duhet me i shtuar të zyra e kuvendit komunal që i kemi pas 14 mijë dhe e heqim shtesën mbesin 4.400 euro që

mos me pas asnjë problem teknik. D.m.th. te shuma e përgjithshme prej 14 mijë euro te zyra e kuvendit shestat më nuk i kemi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Shahadije Dragaçina, tha se e përmendi drejtori që 14 mijë euro te zyra e kuvendit tepricë, qysh ka mundësi që anëtarët e komitetit për komunitetet që nuk janë pjesë e kuvendit me mbet pa pagese që sa kohë.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se pagesat për komitete dhe komisione nuk është mungese e mjeteve por është problem i ligjit. Pasi që nuk ka lënë mundësi për me i paguar. Takimin u fundit që kemi pas në Pejë me kryesues te kuvendit dhe me përfaqësues te ministrisë, është thënë që komunat mund ti paguaje këto komitete dhe komisione, ne baze te mallrave dhe shërbimeve. Ne kemi kërkuar një shkresë zyrtarë nga ana e ministrisë mirëpo dhe pse kaluan gati 2 muaj dhe ende nuk kemi pranuar shkresë.

Arsim Jashari, tha se ne fillimisht ishim kundër kësaj pike qysh po vijnë ne ditën e fundit sepse nuk po mundemi me i përgatitë. Përndryshe ne grupi i PDK-së, e mbështesim këtë vendim sepse nuk mund ti leme punëtorët pa paga.

Alban Salihu, tha se për shkak të mungesës se hapësirës për ta diskutuar këtë propozim vendim ne nuk do te marrim pjesë në votim.

Latif Ramadani, tha se me herët nuk kemi pas kësi praktika, sepse me herët i ka mbuluar minuset ministria. Më herët nuk kemi mujt me pru ne kuvend sepse para dy dite na ka ardhë shkresë nga thesari. Kemi me pas telashe edhe muajt e tjerë për pagesa.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit me ndryshimet që i përmendi drejtori më herët, te zyra e kuvendit te administrata dhe arsimit. Dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 18 vota për, aprovoi propozimin

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 15:00.

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi